



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:253100

Datë: 18.05.2022

Numri i dokumentit: 03027346

PKR.nr.183/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me kryetarin e trupit gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.D, për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.235/21 të dt. 16.11.2021, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 13.05.2022, në prezencë të Prokurorit të shtetit A.G, të pandehurit M.D dhe mbrojtësit të tij av. R.P, i caktuar sipas detyrës zyrtare, në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.18.05.2022, përpiloi këtë merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

M.D, i biri i A dhe nënës X, e gjinisë H, i lindur me dt. ..., në P., me vendbanim në rr."A.Gj" nr. . K-Pejë, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion automekanik, i martuar, babai i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, posedues i nr. tel...-...-..., shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, gjendet në paraburgim për shkak të një vepre tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

- Me parë e gjerë me datë 22.10.2021 rreth orës 20:30, në rr. "M.T", K-Pejë, i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë: një pistoletë S. kalibrit ..mm, me nr. serik ..., një karikator dhe katër (4) fishek të kalibrit ..mm, në atë mënyrë që ditën kritike pasi që policia e Kosovës kanë qenë duke patrulluar në vendin e lartcekur aty kanë ndaluar veturën e llojit A., me ngjyrë të zezë, me targa ...-...-..., të cilën e drejtonte i pandehuri i lartcekur dhe gjatë bastisjes-kontrollës tek i pandehuri policia në çantën e tij kanë gjetur dhe sekuestruar armën dhe municionin me të dhënat lartcekura,

- me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,38,39,40,43,69, të KPRK-së, nenit 366 par.1 dhe 366 par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) euro, e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë, gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të, shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I pandehuri obligohet që në emër të, taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të pandehurit i konfiskohet një pistoletë S. kalibrit ..mm, me nr. serik ..., një karikator dhe katër (4) fishek të kalibrit ..mm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.235/21 të dt. 16.11.2021, ndaj të pandehurit M.D për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 13.05.2022, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar prezentë kane qene Prokurori i Shtetit A.G, i pandehuri M.D,

Meqenëse i pandehuri gjendet në paraburgim për një veprë tjetër penale, Gjykata ia ka caktuar mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. R.P.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1 të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës e pranoi av. R.P i caktuar nga Gjykata sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, kryetari i trupit gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit që të deklarohet për

pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I pandehuri, e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, ndihet i penduar, premtom se më nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit av. R.P është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij pasi që ky pranim është bërë pas konsultimeve me të si mbrojtës i tij.

Kryetari i trupit gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti i policit hetues E.S me nr. te rastit ...-...-... dt.22.10.2021, raporti i oficerit S.A i dt.22.10.2021, raporti i policit F.B i dt.22.10.2021, deklarata e dëshmitarit N.D e dhënë në polici me dt.22.10.2021, deklarata e të pandehurit M.D e dhënë në polici me dt.22.10.2021, dhe në prokurori me dt.12.11.2021 lista e armëve të konfiskuara e dt.22.10.2021, fotografit e armës së sekuestruar si dhe shkresat tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit M.D qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata morri pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra tjera penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata mori faktin se i njëjti edhe me parë ka qenë i dënuar për shkak te veprave tjera penal.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të

pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 50 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, konfiskohen një pistoletë S.kalibrit ..mm, me nr. serik ..., një karikator dhe katër (4) fishek të kalibrit ..mm.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.183/21, dt. 18.05.2022.**

Sekretare juridike
Fitore Bojku

Kryetari i trupit gjykues
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.